

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga pijet alkoolike te motoçikletat, hyn në fuqi urdhri i Trump për bllokimin e importeve kanadeze dhe ndi kimi në ekonominë e fqinjit
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/nga-pijet-alkoolike-te-motocikletat-hyn-ne-fuqi-urdhri-i-trump-per-bllokimin-e-importeve-kanadeze-dhe-ndikimi-ne-ekonomine-e-fqinjit/1032252/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:48:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:45:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f2d8322ce9c0a77b0178d42bc87c5050b1d713ece76d02ed400f09430f250576
TEKSTI	35963e369593eb06a72f795bd74080aca3e179b561588f186edbcbbf3f37d9d1
PAMJA	337b9fe14cc9b2d798998fdf51f88c87ad7d80d752fa533c0bbcff653dea3a46

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	99f0a31a473b7ceb636477ae1167dff712d4200665646ab0b44ff8800bf367b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f52a1d397c683d722882998d1b0c047f87c1de2f74016889fd5b4e655403fa0f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/99f0a31a473b7ceb636477ae1167dff712d4200665646ab0b44ff8800bf367b7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga pijet alkoolike te motoçikletat, hyn në fuqi urdhri i Trump për bllokimin e importeve kanadeze dhe ndikimi në ekonominë e fqinjit



Administrata amerikane ka vënë në zbatim ndalimin e disa importeve nga Kanadaja, mes tyre pijet alkoolike, produktet e bulmetit dhe motoçikletat, duke e përshkallëzuar më tej luftën tregtare mes dy vendeve fqinje.

Vendimi i fundit i administratës Trump erdhi pasi Kanadaja vendosi në fillim të këtij muaji tarifa për një sërë mallrash amerikane, pas ndërprerjes së negociatave tregtare.

Kryeministri kanadez Mark Carney ka deklaruar se Otava nuk pritet të marrë masa të tjera hakmarrëse. Sipas tij, ndikimi i ndalimeve amerikane në ekonominë kanadeze do të jetë "modest".

Ndërkohë, negociatat mes dy vendeve vazhdojnë të jenë të pezulluara. Përfaqësuesi amerikan i tregtisë, Jamieson Greer, i tha CNBC-së se Presidenti Donald Trump është "i kënaqur" me marrëdhëniet aktuale me Kanadanë.

"Ata na telefonojnë herë pas here dhe ne zhvillojmë biseda të mira rreth marrëveshjeve të mundshme. Por nuk ka urgjencë nga ana jonë," u shpreh Greer.

Masa e shpallur të martën prek rreth 1 miliard dollarë kanadezë, ose 710 milionë dollarë, në eksporte të pijeve alkoolike drejt SHBA-së. Në listën e produkteve të ndaluara përfshihen edhe produktet e hirrës që përdoren në prodhimin e pluhurit proteinik.

Edhe eksportet e motoçikletave do të preken nga ndalimi. Megjithatë, sipas të dhënave kombëtare të Statistikave të Kanadasë, gjatë vitit 2025 Kanadaja dërgoi në SHBA vetëm rreth 5,000 motoçikleta, me vlerë afërsisht 120 milionë dollarë kanadezë, ndaj pasojat për këtë sektor pritet të jenë minimale.

të fundit /



SHBA përmbyll praninë ushtarake në Irak pas 23 vitesh, rriten...



Nga pijet alkoolike te motoçikletat, hyn në fuqi urdhri i Trump pë...



Specialja apo Presidenti? - PDK-ja dhe LVV-ja ende larg...



Tentuan t'i merrnin 100 mijë euro Armand Dukes duke u...



FOTO/ Nga eleganca klasike te guximi në stil, yjet që morën...



Yamal rrëfen mesazhin prekës që i dha Messit pas finales së Botërorit



Meloni fiton përballjen e parë para zgjedhjeve të përgjithshme, kandid...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ndalimet u bërë publike për herë të parë nga Trump përmes një serie uranirash ekzekutive të nirmosur me shtator. Në këto dokumente, presidenti amerikan tha se masat ishin kundër "diskriminimit të vazhdueshëm" të Kanadasë ndaj produkteve amerikane të qumështit, automobilave dhe alkoolit.

Trump e akuzoi gjithashtu Kanadanë se "po i trajton Shtetet e Bashkuara shumë padrejtësisht".

"Ata kanë qenë një nga vendet më të këqija në të gjithë botën", deklaroi ai.

Carney kishte theksuar më herët se ndalimet ishin "masa relativisht modeste" krahasuar me veprimet e tjera tregtare të ndërmarra nga SHBA-të ndaj Kanadasë.

Megjithatë, kryeministri kanadez pranoi se bizneset dhe sektorët e goditur drejtpërdrejt do të përballen me pasoja.

Derek Holt, ekonomist në bankën kanadeze Scotiabank, shkroi në një analizë se "këto veprime janë për të shpëtuar fytyrën nga administrata amerikane, jo të natyrës substanciale dhe kjo është pozitive".

Varësia e sektorit kanadez të pijeve alkoolike nga tregu amerikan është e lartë. Rreth 93% e eksporteve kanadeze të këtyre produkteve gjatë vitit 2025 u shitën në SHBA. Organizata Spirits Canada, e cila përfaqëson prodhuesit kanadezë të pijeve alkoolike, paralajmëroi se pasojat për industrinë "mund të jenë të rëndësishme".

Ekonomistët dhe kompanitë kanë ngritur shqetësime edhe për pasigurinë që këto vendime mund të krijojnë lidhur me të ardhmen e marrëdhënieve tregtare të Kanadasë me SHBA-në, partnerin e saj më të madh ekonomik.

Përveç ndalimeve të reja, Shtetet e Bashkuara kanë vendosur tarifa prej 50% për një sërë produktesh kanadeze, përfshirë mallrat e qumështit, pijet alkoolike, çelikun dhe aluminin. Ndërkohë, për automjetet e prodhuara në Kanada aplikohet një tarifë prej 25%.

Si kundërpërgjigje, Kanadaja ka vendosur tarifa nga 15% deri në 50% për më shumë se 700 produkte amerikane, si dhe një taksë prej 25% për disa produkte çeliku dhe alumini. Shumica e provincave kanadeze kanë ndaluar gjithashtu shitjen e pijeve alkoolike amerikane.

Shtuar më 29.09.2026 11:45



Arrestohet ish-ministri hungarez i Kulturës, dyshohet për abuzim me...



SHBA përmbyll praninë ushtarake në Irak pas 23 vitesh, rriten shqetësimet...



Meloni fiton përballjen e parë para zgjedhjeve të përgjithshme, kandidati i...



CNN, MS NOW dhe Politico kërkojnë nga gjykata të mos rikthehet...



Rrëshqitjet dhe përmbytjet godasin Nepal: të paktën 21 viktima, 12 persona të...



Greqia synon të krijojë qendër për migrantët e refuzuar në Afrikë:...



Përplasja për naftën në Falkland shpërthen sërisht, Milei paralajmëron...



Të shtëna vdekjeprurëse në Guatemalë: shtatë të vrarë, ngrihen dyshime p...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim

Kategori

Lifestyle
Showbiz

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri

Tags

Edi Rama
Albania News

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.